



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 251, datë 13.12.2021,**

**MBI**

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE  
(NËPËRMJET SHITBLERJES) TË SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER”  
SH.P.K. NDËRMJET ORTAKËVE EKZISTUES TË SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 6.2, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 151/9 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të saj”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.04.2020.
- Shoqëria ka vënë në dijeni ERE-n për transferimin e kuotave ndërmjet ortakëve ekzistues të saj.
- Në zbatim të pikës 6.2, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE në lidhje me ndryshimin e ortakut/aksionerit kryesor.
- Të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE në lidhje me ndryshimin e ortakut/aksionerit kryesor, në zbatim të pikës 6.2, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 218, datë 27.10.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave”, vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave.

- Kjo shtyrje erdhi si pasojë e nevojës për të sqaruar rrethanat dhe dokumentacionin që lidhet me barrësimin e kuotave të të tretët, për të cilat shoqëria ka kërkuar autorizimin e ERE-s për transferimin brenda shoqërisë dhe për zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore për këtë qëllim e për të sqaruar statusin e barrës sigurorese që vetë shoqëria ka vendosur mbi këto kuota.
- Në seancën dëgjimore të datës 22.11.2021, përfaqësuesit e shoqërisë deklaruan se shoqëria ka marrë miratimin përkatës të bankës për këtë transferim, dokument i cili është depozituar në ERE.
- Në kuadër të kërkesës për marrjen e miratimit të ERE-s për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) ndërmjet ortakëve ekzistues të saj, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.
- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për vënien në dijeni për transferimin e kuotave ndërmjet shoqërive ortakë ekzistuese të shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. Në lidhje me këtë njoftim që i ka bërë MIE-s, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, vetë shoqëria ka argumentuar në shkresën e saj drejtuar ERE-s se referuar nenit 17.1, të kontratës së koncesionit nr. 1605 rep., nr. 1057 kol., datë 18.07.2018, ku parashikohet se, *për çdo transferim të aksioneve të kapitalit themeltar tek të tretët, koncesionari duhet të marrë pëlqim paraprak të autoritetit kontraktues*, shoqëria si mbajtëse e koncesionit ka të drejtë që brenda saj të ndryshojë/transferojë aksionet e shoqërive të saj pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktues, pasi në këtë rast nuk është transferim të të tretët, por transferim/shit-blerje e aksioneve brenda shoqërisë. Po ashtu, gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e ERE-s pyetën përfaqësuesit e shoqërisë në lidhje me qëndrimin e MIE-s për sa informuar nga shoqëria, të cilët ritheksuan edhe një herë faktin se në zbatim të përcaktimeve të nenit 17.1, të kontratës koncesionare kanë vetëm detyrimin për të njoftuar MIE-n, në cilësinë e AK-së, pasi transferimi i kuotave nuk bëhet të të tretët.
- Në çdo rast, vlerësohet të theksohet se shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera në lidhje me këtë transferim, kur kjo kërkohet nga këto organe.
- Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të shoqërisë.
2. Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**